


# TRIBUNA SINDIKALE

Shtator 2006

Dhe drit' e diturisë  
përpara do na shpjerë



Editorial**SINDIKATAT E ARSIMIT PERBALLE DETYRAVE**

Viti ri shkollor 2006- 2007 që starton me 18 shtator nis me festën tradicionale që përfshin gjithë vendin. Por ditët, javët dhe muajt që pasojnë dëri në përfundim të tij përbejnë një periudhë të gjatë pune të ngjeshur e intensive, që kërkon angazhim e përkushtim nga mesuesit e mësuesit, nga drejtuesit e arsimit të të gjithë niveleve, nga partnerët sociale dhe aktorët e tjerë që janë rreshtuar në frontin e reformimit dhe modernizimit të arsimit në vendin tonë.

Në këtë front të dijes e kultures, sindikatat e arsimit FSASH e SPASH dhe miçjera mesuesit sindikaliste që ato përfaqësojnë kanë përballë detyra dhe objektiva të reja e të mëdha. Nën këto detyra e objektiva, kryesore mbetet vazhdimi i procesit për fuqizimin e sindikatave të arsimit. Ky proces fuqizimi, që në thelb është reformim dhe demokratizim i jetës së sindikatave për t'iu përgjigjur në mirë detyrave të reja të kohës, përfshinë të gjithë strukturat sindikale, që nga keshilli sindikal i bazës e deri në organet në të larta drejtuese. Por në periudhën që kemi përpara dhe që përkon me vitin e ri akademik, sindikatat sindikatat tona janë përqendruar me shumë në nevojën për fuqizimin e seksioneve sindikale në rajone e rrethë. Kjo sepse seksionet sindikale kanë tani në dorë një dokument të rëndësishëm, sic është Kontrata e re Kolektive e Punes, që i shtrinë efektet deri në 31 dhjetor 2009. Studimi, zërtimi, përvetësimi dhe puna për zbatimin e këtij akti baze në status ligjor është kushti kryesor që u mundëson seksioneve sindikale të programojnë veprimtarinë e tyre, të krijojnë një vizion me të çartë për angazhimin e tyre në partneritetin me punëdhënësin për të mbrojtur në mirë të drejtat, kërkesat dhe interesat e anetareve që përfaqësojnë.

Kontrata Kolektive e Punes përbën një teresi normash që përfaqësojnë standardet e sotme të përparuar të marrëdhënieve të punës midis punëdhënësit dhe punëmarësit. Si të tilla, këto norma garantojnë mundësinë për një mbrojtje efektive sociale ekonomike të sindikalistëve mesues dhe anetareve të tjerë në strukturat e arsimit. Por e rëndësishme është që të kuptohet nga të gjithë, drejtues sindikale të bazës, sindikaliste dhe mesues se ato që garanton Kontrata, ligji dhe konventat ndërkombëtare nuk realizojnë vetvetiu mbrojtjen sindikale dhe procesin sindikal. Këto norma mbeten pa jete dhe nuk sjellin

asnjë efekt pozitiv nëse nuk mishiheren në veprimtarinë sindikale, në aksionin sindikal; nëse nuk zhvillojnë një luftë të papajtuësme me pasivitetin dhe indiferentizmin që ende karakterizojnë shumë mesues e anetare të sindikates dhe disa struktura sindikale në rajone e rrethë. Koncepti i pritmerisë në shprehjen e kote se problemet e shqetsimit i zgjidhen të tjerët, se ato zgjidhen nga lart, paralizojnë sindikatën, në inekzistente forca realizuese të saj dhe i heq çdo mundësi për një dialog social e partneritet dinjitoz me punëdhënësin me DAR ose ZA, të bazuar në objektivitetin, në harmonizimin në mirë të të drejtave të detyrat, që do të thotë se krahas garantimit të të drejtave të anetareve sindikatat marrin përgjegjësi dhe angazhohen efektivisht në procesin e reformimit dhe modernizimit të shkollës.

FSASH e SPASH fuqizimin e të gjithë strukturave sindikale dhe vecanrisht seksionet në rajone e rrethë i kushtojnë edhe me angazhimin për plotësimin e detyrave dhe objektivave të tjera të rëndësishme në këtë vit të ri shkollor. Nën këto detyra e objektiva, vend të vecantë ze puna për diskutimin dhe hartimin e draftit për Statusin e Mesuesit. Sic është sanksionuar edhe në Kontraten Kolektive kjo punë duhet të përfundojë brenda këtij viti mbasi tani janë përkur edhe kushtet për miratimin e tij.

Gjatë këtij viti akademik në vëmendje të të dy sindikatave qëndrore do të jetë edhe ristrukturimi dhe gjallërimi i jetës sindikale në arsimin e lartë dhe sektorin shkencor. Programi që është hartuar për këtë qëllim përbën detyra dhe synime konkrete, përfshinë edhe tërheqjen e organizatave të studenteve në objektivat e sindikatave.

Në këtë vit shkollor sindikatat e arsimit kanë parashikuar që ta zgjerojnë objektin e punës së tyre duke tërhequr në sindikatat tona edhe mesuesit e pedagogët e sektorit jpublik.

Në këtë sektor, i cili po zgjerohet vazhdimisht, punëmarësit kanë nevojë për një mbrojtje sociale në standardet dhe nivelin e kohës.

Sfidë të vërtetë për sindikatat e arsimit përben blloku i detyrave dhe angazhimeve të tyre që lidhen me reformimin dhe modernizimin e arsimit, me përmirësimin e sistemit të pagave e shpërblimeve dhe me studimin e ngarkesës mesimore.

**PERMBAJTJA**

✓ Editorial: Sindikatat e arsimit përballë detyrave	2
✓ Përsëritje me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor	3
✓ Arsimimi, arma më e fuqishme për të ndryshuar botën, (me rastin e 5 Tetorit)	4
✓ Konferencë rajonale për eliminimin e punës së femijeve	6
✓ Edhe detyrat krahas me të drejtat	6
✓ Forca e sindikates varet nga angazhimi i anetareve	7
✓ Kontrata Kolektive e Punes	8
✓ Të reja shkencore dhe keshilla praktike	15

**Kopertina e pare:**

Çast nga ceremonia e nënshkrimit të Kontrates Kolektive të Punes

**Kopertina e fundit:**

Interesimi i medias për nënshkrimin e Kontrates Kolektive të Punes me MASH

**TRIBUNA SINDIKALE****Nr. 23, Periodike**

Botim i FSASH dhe SPASH  
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"

Pallati Ali Kelmendi, kati III,

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

**Keshilli Botues:**

Xhafer Dobrusha,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

## Pershendetje me rastin e fillimit te vitit te ri shkollor

Xhafer DOBRUSHI, Kryetar i FSASH



Te dashur sindikaliste, mesues, nxenes dhe prinder, 18 shtatori, eshte dita e pare e shkolles, eshte dita kur qindrimi je nxenes dhe rreth 40.000 mesues ne te gjitha vendin nisin "betejen" e re te dijes, qe

do te vazhdoje gjate gjitha vitit akademik 2006/2007. Tashme eshte bere tradite qe dita e pare e shkolles te jete edhe nje dite feste e gezimi per nxenesit e mesuesit, per prinderit dhe gjitha popullin.

Ne kete dite te shenuar, Kryesia e FSASH, pershendet e pergezton perzemerisht mesuesit sindikaliste, gjitha punonjesit e arsimit, nxenesit e prinderit dhe u uron atyre nje vit te suksesshem ne udhen e veshtire per dije e kulture

dhe uron qe ky vit te shenoje hapa te rëndësishëm në konsolidimin e shkolles, në nritjen e cilësisë së procesit mesimor, në reformimin dhe modernizimin e tij.

FSASH me gjitha potencialin e anëtarëve që përfaqëson, do të jetë e angazhuar dhe e vendosur që të kryej misionin e një partneri social të përgjegjshëm e serioz, duke dhënë ndihmesën e vetë për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballë shkollla në kete etape të rëndësishme të

zhvillimit të vendit.

Le të na shërbejë festa e dites së parë të shkolles edhe si një reflektim që secili nga ne mesuesit e sindikalistet, të vënë me mirë në dispozicion të shoqërisë e të atdheut, të edukimit të brezit të ri, mëndjen, njohuritë dhe energjitë tona, që ta bëjnë shkollën vater të vertetë e të shenjtë të formimit shkencor e atdhetar të brezave të ardhshëm.

Edhe një herë: Gezuar e suksese në vitin e ri shkollor!

Bajram KRUJA, Kryetar i SPASH



Te dashur nxenes, prinder dhe mesues,

Gezuar fillimin e vitit të ri shkollor. Me 18 shtator starton edhe një vit i ri mesimor, ku secili është një vit me lart në përparim për të ardhmen e vet dhe të vendit në

teresi.

Kerkesat në nritje për edukimin dhe arsimimin duhet të jenë kërkesa në nritje për të gjithë ne, për të arritur rezultate sa më të larta në përvetësimin e dijeve dhe edukimin e gjithanshëm.

Është e vertetë që në shumë shkollla janë përmirësuar kushtet për përvetësimin sa më të mirë të dijeve dhe pritet që të tilla kushte të krijohen gjatë vitit edhe në shkolllat e tjera kuqë në vendin tonë, me qëllim që ju, nxenes të dashur, kuqë të jeni të përvetësoni

njohuritë bashkëkohore dhe të konkurojnë me dinjitet në të gjitha shkolllat kuqë në botë.

Ju lutem juve, të dashur prinder, për dashamirësinë që keni për shkolllën. Shumë prej jush, me sakrificë të mëdha, po arsimoni fëmijet tuaj dhe ata po nderojnë veten, po jundërojnë ju dhe sigurisht edhe vendin tonë.

Mesues sindikaliste, kërkesa jone që arsimi të jetë prioritet i Qeverisë është tashmë një realitet. Rritja e pagave me synim dyfishimin e tyre brenda një mandati 4-vjeçar

është një gjë e pranueshme që tregon se partneriteti kontraktual me MASH, DAR dhe ZADo të vijë duke u përmirësuar, duke shmangur edhe disa shqetësime që kanë të bëjnë sidomos me levizjet e pamotivuara të mesuesve, shmangien e braktisjes së shkolles etj.

Me kete rast, në ju urojmë të gjithëve për të mirë e suksese, duke pershendetur dhe duke u unuar udhë të mirë në rrugën e dijes, sidomos vogëlusheve që sivjet fillojnë shkollën për herë të parë.



## Arsimimi është arma më e fuqishme për të ndryshuar botën

Me rastin e 5 tetorit, Ditës Botërore të Mësuesve

Në 5 Tetor çdo vit, organizatat e mësuesve në mbarë botën mobilizohen për të siguruar që të merren në konsideratë nevojat e brezit të ardhshëm.

UNESCO e përuroi 5 Tetorin si Ditën Botërore të Mësuesve në vitin 1994, për të përkujtuar firmosjen e përbashkët të Rekomandimeve të UNESCO/ILO në 5 Tetor 1966 që kanë të bëjnë me Statusin e Mësuesit. Dita Botërore e Mësuesve, gjithashtu, evokon Rekomandimet e UNESCO-s që lidhen me Statutin e Personelit të Arsimit të Lartë të miratuar në vitin 1997. Sipas UNESCO-s, Dita Botërore e Mësuesve përfaqëson një përkujtim të rëndësishëm të ndërgjegjësimit, kuptimit dhe vlerësimit të treguar për kontributin jetësor që kanë mësuesit për arsimimin dhe zhvillimin.

Federata Ndërkombëtare e Arsimit (EI) mendon se kjo Ditë duhet të njihet dhe të festohet në mbarë botën.

Më shumë se 100 vende krentojnë Ditën Botërore të Mësuesve. Përpjekjet e Federatës Ndërkombëtare të Arsimit, EI, dhe 348 organizatave anëtare të saj kanë kontribuar për këtë përhapje të gjerë të njohjes së kësaj dite.

Çdo vit EI zhvillon një fushatë njëjavore për ndërgjegjësimin e publikut për të theksuar kontributin e profesionit të mësuesit. Këtë javë, EI thekson faktin që mësuesit e botës shprehin që autoritetet e arsimit në të gjithë botën do të zbatojnë

Rekomandimet e vitit 1966 mbi Statutin e Mësuesit si dhe Rekomandimet e vitit 1997 mbi Statutin e Personelit të Arsimit të Lartë për të sjellë në standardet e

Mësimdhënës të Arsimit të Lartë përfaqësojnë një pjesë formale nga ana e Anëtarëve të Shteteve për nevojën për të drejtuar çështje të zakonshme për sa i përket statusit të personelit



duhura kushtet e punës së mësuesve dhe ambientin mësimor të studentëve.

Në 40 vitet e shkuara, ka pasur zhvillim të dukshëm në përmirësimin e sistemit të arsimit publik në të gjithë botën. Megjithatë, duhet bërë më shumë, siç do të pasqyrohet me hollësi në raportin e ardhshëm të Federatës Ndërkombëtare të Arsimit për Komitetin e Eksperteve mbi Rekomandimet për Mësuesit nga ILO/UNESCO (CEART). Federata Ndërkombëtare e Arsimit konsideron se zbatimi i Rekomandimeve të vitit 1966 duhet të jetë i detyrueshëm në të gjitha vendet.

Rekomandimet e vitit 1997 të UNESCO-s mbi Statusin e Personelit

të arsimit të lartë në të gjitha vendet nëpërmjet zbatimit të rregullave të përbashkëta. Fakti që sektori i arsimit të lartë ndikohet nga presionet e tregut dhe kërcënimet e komercializimit në baze të Marrëveshjeve të Përgjithshme të Shërbimeve të Tregut, (GATS), dhe marrëveshjeve të tjera të tregut, bëhet thirrje për zbatimin e menjëhershëm të Rekomandimeve dhe publicitetit mbi këtë çështje.

Tema e Ditës Botërore të Mësuesve për vitin 2006 është "Mësues Cilësorë për Arsim Cilësor". Ky është një vit përvjetor që shënon 40-vjetorin e miratimit të Rekomandimeve që lidhen me

Statusin e Mësuesve (1966). EI fiton mësuesit për të përdorur këtë mundësi për të riparë zbatimin e Rekomandimeve të vitit 1966, të cilat janë i vetmi standard ndërkombëtar i zbatueshëm për të gjithë mësuesit në shkollat publike dhe private duke përfshirë edhe ata që kanë arsim teknik, profesional apo artistik.

Ka shumë gjëra që mësuesit dhe sindikatat e mësuesve mund të bëjnë për të përkujtuar Ditën Botërore të Mësuesve. Në vijim janë disa shembuj, sa për frymëzim:

- Në sindikatën tuaj organizoni seanca informimi dhe debati me anëtarët e sindikatës për të diskutuar rëndësinë e Ditës Botërore të Mësuesve dhe kërkesat për arsim cilësor;

- Ngrini ndërgjegjësimin për Rekomandimet mbi Statusin e Mësuesit, duke organizuar aktivitete publike si demonstrata, seminare dhe debate;

- Takoni drejtuesit politikë dhe ndikoni në institucionet lokale dhe kombëtare për të zbatuar Rekomandimet e vitit 1966;

- Organizoni aktivitete të përbashkëta me Ministrinë e Arsimit për të treguar rëndësinë e arsimit cilësor;

- Bashkohuni me organizata të tjera të interesuara për të zhvilluar fushata për të drejtat e mësuesve në Ditën Botërore të Mësuesve dhe për të debatuar çështjen e Arsimit Cilësor Për Të Gjithë.

- Organizoni aktivitete të ndryshme në shkolla, si drama, parada, konkurse, që kanë për bazë temën e Ditës Botërore të Mësuesve, "Mësues Cilësorë për Arsim Cilësorë".

- Diskutoni problemet me të cilat përballen mësuesit dhe studentët në vendin tuaj. Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar situatën? Bëni një tabelë me këto ide për t'ua prezantuar

politikanëve lokalë dhe përfaqësuesve të qeverisë.

Edhe sindikatat shqiptare të arsimit, FSASH dhe SPASH, duke vlerësuar rëndësinë e kesaj dite, po marrin të gjitha masat që edhe në vendin tonë të zhvillohen aktivitete të larmishme në nivel qendror e në shkallë seksionale në rrethe.

Me këtë rast, FSASH e SPASH, po shprehin materialet e posaçme për të ndërgjegjësuar mësuesit dhe sindikatat në shkolla për vlerësimin e kesaj Dite, si një rikonsiderim i rolit të mësuesve në shoqërinë tonë.

Nërkohë, Seksionet sindikale në disa rrethe po përgatiten për të organizuar aktivitete të posaçme me pjesëmarrjen e mësuesve e sindikalistëve, ku do të flitet për rolin e mësuesve, detyrimet e organeve shtetore e qeveritare dhe detyrat e sindikatave për një vlerësim me të mirë të figureve të mësuesit në shkollë e në shoqëri.

## Deklaratë e Federatës Ndërkombëtare të Mësuesve, EI

### Me rastin e 5 Tetorit

Në, mësuesit e botës:

Kërkojmë që autoritetet e arsimit në të gjithë botën të zbatojnë Rekomandimet e vitit 1966 mbi Statusin e Mësuesve si dhe Rekomandimet e vitit 1997 mbi Statusin e Personelit të Arsimit të Lartë, në mënyrë që të sillen në standardet e dhura kushtet e punës së mësuesve dhe ambientet mësimore të studentëve;

Kërkojmë që e drejta e çdo fëmije për arsim cilësor falas, financuar publikisht, të sigurohet në të gjithë botën;

Nxsisim organizatat në qeveritare dhe shtetet anëtare për të pëmbushur angazhimin e tyre për të arritur Synimet e Zhvillimit të Mi-jëvjeçarit, përfshirë edhe Arsimin Për Të Gjithë dhe për të konsideruar arsimin si një

shërbim publik dhe jo një produkt;

U bëjmë thirrje qeverive për të planifikuar mënyrat e nevojshme për të pasur mësues cilësor, për të arritur nevojat e së ardhmes edhe nëpërmjet mbështetjes së plotë të komunitetit ndërkombëtar të dhuruesve;

Bëjmë thirrje që të dëgjohet zëri i mësuesve dhe sindikatave të tyre në debatet për arsimin cilësor, si partnerë të plotë, profesionistë, në proceset e vendimarrjes dhe për praktika dialogu social dobipurës që të zhvillohen në çdo komb dhe në të gjitha nivelet.

Zotohemi për të punuar me nivelet në të larta të profesionalizimit, për të siguruar arsim cilësor për të gjithë fëmijët në botë;

Këmbëngulim që arsimi cilësor

mund të arrihet me mësues të kualifikuar që janë trajnuar në nivele të larta, duke patur akses në trajnime të përshtatshme dhe që kanë në dispozicion të tyre mjete pedagogjike që bëjnë që atë të sillen si profesionistë në arsim;

Detyrojmë qeveritë të marrin seriozisht angazhimet e tyre për të siguruar paga dhe të drejta të barabarta për femrat si dhe për të siguruar fuqizimin e tyre në ambientin e arsimit, në vendimarrje dhe në vendin e punës;

Thëksojmë rolin që ne, mësuesit e botës, duhet të luajmë për të siguruar arsim cilësor për të gjithë fëmijët, një mision që nuk mund të arrihet pa mbështetjen e plotë të komuniteteve kombëtare, rajonale dhe botërore.

## Konferencë rajonale për eliminimin e punës së femijeve

Ne vijim të aktiviteteve që FSASH e SPASH janë duke organizuar në kuadrin e zbatimit të Projektit që ato kanë me sindikatat holandeze AOb/FNV, me mbështetjen edhe të

ILO-IPEC në Tiranë, në datat 20 dhe 21 tetor 2006, do të organizohet në Hotel Tirana International, Konferenca Rajonale me temë "Sindikatat dhe Puna e Femijeve".

Në Konferencë pritet të marrin pjesë përfaqësues të dy sindikatave tona të arsimit, sidomos nga rrethet Tirane, Elbasan, Shkoder dhe Fier, ku është përqendruar me shumë puna e tyre në kuadrin e këtij projekti, si edhe përfaqësues e partnerë të ILO-IPEC dhe të disa OJF-ve të angazhuara në parandalimin dhe eliminimin e punës së femijeve në vendin tonë.

Në Konferencë pritet të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të arsimit nga Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Bullgaria, Rumania dhe Moldavia, si edhe përfaqësues nga sindikatat holandeze, AOb e FNV, nga Konfederata Nderkombetare e Sindikatave të Lira, ICFTU, Federata Nderkombetare e Arsimit, EI, dhe nga ILO - IPEC në Gjeneve.

Konferenca pritet që të ndiqet e të pershendet edhe nga përfaqësues të lartë të shtetit, të qeverisë dhe të Ministrisë së Arsimit e asaj të Punës.

Konferenca do të jete një rast i mirë, jo vetëm për të bërë një analizë të asaj që është bërë dhe që mendohet të bëhet në të ardhmen nga ana e sindikatave, por edhe për një koordinim të kësaj pune me organizmat e tjera shtetërore, me ILO-IPEC, me organizatat

jofitimpruese të angazhuara në këtë çështje, si edhe me organizmat sindikale ndërkombetare dhe europiane.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të sindikatave rajonale të arsimit synon që të nxisë bashkërendimin e kësaj pune në nivel rajonal, si edhe angazhimin gjithnjë e më të madh të tyre në këtë çështje tëpar te mprehte që ka të bëjë me të ardhmen e vendeve tona.

Konferenca pritet të jete interesante dhe e larmishme edhe përsa i përket mënyrës së zhvillimit të saj. Ajo do të ketë një seancë hapjeje, ku do të paraqitet edhe një pëmbledhje e punës së bërë dhe synimeve për të ardhmen, disa pershendetje nga përfaqësues të lartë të shtetit e qeverisë, prezantime nga përfaqësuesit e sindikatave të rajonit, si edhe një seancë pune në baze, në zonen e Bathores, dhe një seancë me tre workshope ku do të diskutohen çështje të rëndësishme që lidhen me problemin, si ajo e legjisllacionit përkatës, rolit të sindikatave, sistemit të monitorimit e të bashkëpunimit etj.

Drejtuessit dhe përfaqësues të tjerë të dy sindikatave tona të arsimit dhe ILO-IPEC në Tiranë, në konsultim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e sindikatave holandeze dhe

ILO-IPEC në Gjeneve, po punojnë me përgjegjësi për të marrë të gjitha masat që kjo Konferencë të jete një aktivitet efektiv që do bëjë analizën, por, në të njëjtën kohë, do të verë edhe bazat për një punë me rezultative në të ardhmen.

Stavri LIKO

## Edhe detyrat krahas me të drejtat

Para disa ditësh, Komisioneri për Fëmijët promovoi disa letra për të luajtur, (loixhozi), që kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin tek fëmijët në lidhje me të drejtat e tyre si individë.

Letrat shumëngjyreshe dhe tërheqse u drejtohen fëmijëve të moshës midis tre dhe pesë vjeç, megjithëse, për të qenë të saktë, ato duket se

të ishte përfshirë.

Fëmijët, si kushdo, kanë të drejtat e tyre që duhet të mbrohen. Megjithëse ndoshta ata janë shurë të vegjël për të kuptuar domethënien e asaj që është një "e drejtë", është e rëndësishme që ata që në moshë të vogël të dinë cilat janë të drejtat e tyre në jetë. Të rriturit duhet të dinë që fëmijët janë individë me të drejtat e



janë në të përshtatshme për fëmijë në të rritur që kanë njohuri në leximin e gjuhës.

Por nuk është ky theloi. Qëllimi i një aktiviteti të tillë është të ngulitet tek fëmijët, që në moshë të re pra, rëndësia e njohjes së çfarë duhet të presin ata nga të rriturit, veçanërisht nga edukatorët dhe prindërit e tyre.

Letrat përbëhen nga gjashtë çifte që fëmijët duhet të mësojnë t'i bashkojnë në mënyrë që të dinë cilat janë të drejtat e tyre.

Shkurtimisht, të drejtat e përmendura janë: e drejta për t'u argëtuar me shokët; për të mësuar; për një mjedis të pastër; për të pasur për-kujdesje; për të luajtur dhe për të pasur të drejta si gjithë të tjerët. Ndoshta edhe e drejta për një naivitet fëmije, në kuptimin e gjerë të fjalës, duhet

tyre dhe prandaj duhet të respektohen si të tillë.

Por një faktor tjetër i rëndësishëm që duhet të theksohet është se fëmijët nuk kanë vetëm të drejta, por kanë detyrat e tyre, gjithashtu. Kur theksojmë të drejtat e tyre, që, duhet të përsëritet, janë të rëndësishme në rritjen e tyre, ne kemi tendencën të injorojmë faktin, që edhe fëmijët, si kushdo, kanë edhe detyrat e tyre. Dhe detyrat janë po aq të rëndësishme sa edhe të drejtat.

Nga mënyra si ka evoluar dhe po zhvillohet shoqëria, duket se ne po përqendrohemi më shumë tek të drejtat në kurriz të detyrave, në vend që t'i vendosim ato në të njëjtën pozitë.

Po aq sa fëmijët duhet të dinë që kanë të drejtë të mësojnë dhe të luajnë, ata duhet të dinë edhe cilat janë

detyrat e tyre, për shembull, të luajrë rolin e tyre në familje dhe në shkollë, të bëjnë ç'është e mundur në shkollë dhe në familje dhe të respektojnë ata që po kujdesen për ta. Kjo vetëm për të dhënë disa shembuj.

Këto detyra në një farë mënyre po humbasin sepse në përgjithësi tek të drejtat. Ndoshta primërit e sotëm ndihen fajtor që nuk kalojnë shumë kohë me fëmijët për shkak të ngarkesës së punës, veçanërisht nëse të dy primërit janë të punësuar. Kjo ndjeshi faji bën që primërit të injorojnë detyrat e fëmijëve të tyre. Kjo po sjell një gjeneratë me fëmijë të përkëdhelur që po rriten duke e ditur me saktësi cilat janë të drejtat e tyre por duke njohur pak atë çfarë pritet prej tyre.

Për shembull, fëmijët duhet të mësojnë të respektojnë autoritetin, në kuptimin në të gjerë të mundshëm, dhe kjo sigurisht përfshin respektimin e prindërve dhe mësuesve. Janë ditë të shkuara ato kur fëmijëve u mësohej të kishin frikë nga policia nëse nuk bindeshin dhe kjo është e drejtë sepse policia nuk duhet të sjellë frikë. Por nga ana tjetër, sot fëmijët duket se tregojnë më pak respekt për të rriturit, kushdo qofshin ata, dhe kjo çon në një shoqëri të rriturish që nuk ka respekt për autoritetin. Këto dy ane duhet të funksionojnë në të dyja mënyrat.

Është e rëndësishme që fëmijët të dinë cilat janë të drejtat e tyre dhe nëse këto shkelen, përgjegjësit duhet të hetohen. Por duhet të theksohen, gjithashtu, detyrat që kanë fëmijët ndaj të rriturve, veçanërisht ndaj prindërve, të afërmeve dhe mësuesve, që, në fund të fundit, janë aty për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Marre nga Gazeta malteze "Independent"

## Forca e sindikates varet nga angazhimi i anetareve

Sindikalisti është i aftë të dallojë detyrat dhe të drejtat, kur ai është i informuar dhe i përgatitur mirë në fushën ku punon.

Në arsim cob anetar i SPA-se jep kontributin e tij për rimbartjen e punëve në shkollë, përfshirë edhe problemet e përmirësimit të programeve mesimore e formuese dhe metodat e mësimdhënies, që ato të jenë sa më bashkëkohore dhe frytëdhënëse.

Gjate kontakteve me seksionet e SPA-se në shkollat e Qarkut Tirane, anetare të veçantë, kanë shfaqur mendimin se mjaft materiale ndjeshë nuk shkojnë deri tek anetari i thjeshtë. Kjo ka detyruar drejtuesit sindikaliste të shkolles që të vihen në levizje, duke kërkuar nga drejtuesit e SPA-se në rreth materiale që i shërbejnë një pjesë të detyrat si anetare e si mësues, si edhe me të drejtat e tyre.

Në mjaft sindikata shkollash kontratat kolektive nuk njihen sa duhet. Nga disa vezhgime që kemi bërë del se vetëm drejtori i shkolles e mbante atë në dosjen e tij, ndërsa mjaft mësues të SPA-se nuk dinin çfarë përmbante kontrata, sepse nga drejtuesit e meparshëm të arsimit në rreth nuk i lejonin kryetaret e SPA-se të punonin me anetaret e sindikates.

Një situatë e tillë shtrihet përpara drejtuesve të rinj të SPA-se të Qarkut Tirane detyren që, pas nënshkrimit të kontrates kolektive të nivelit të dytë, gjë për të cilën deri tani jemi në hapat e para, (SPA, DAR, FSASH.), të njohin të gjithë anetaret e saj nëpërmjet kryetareve të shkollave.

Nga drejtuesit sindikaliste nëpër shkollë kanë dalë shumë probleme të cilat do të futen në kontaktin kolektiv të nivelit të dytë, siç është transporti i

nxenesve dhe mësuesve. Në mjaft shkollë një pjesë e transportit të mësuesve është përballuar nga xhepi i tyre, ndërsa për nxenesit as që bëhet fjalë. Kjo ka ardhur për shkak se tarifatat e caktuara për transport, janë të ulta dhe nuk i përgjigjen gjendjes reale të vlerës.

Me nënshkrimin e kontrates kolektive, do të punohet për organizimin e kualifikimit të drejtuesve të seksioneve, duke synuar, gjithashtu, që dhe me cob anetar të bëhet një punë kualifikuese e programuar mirë nga drejtuesit SPA të Qarkut.

Mendimet për rimbartjen e punës në sindikate nuk kanë munguar edhe nga anetaret e thjeshtë të sindikates.

Mendime të pjekura, janë parashtruar nga mësuesit anetare të SPA në shkollat Yzberisht, Barzhitë, Ibo etj. Por vlen të përmendim se ka dhe disa shkollë të tjera ku akoma nuk janë organizuar sindikatat. Mjaft mësues hezitojnë, qendrojnë indiferent dhe nuk aderojnë në sindikate, gjë që vjen edhe nga mosnjohja dhe mosangazhimi në problemet që ata kanë pasur.

Mësuesi duhet të jetë i vetdijshëm se problemet që e shqetsojnë, përkrahësit që i bëhen, zgjidhen me mirë duke u angazhuar në sindikate dhe duke u angazhuar të gjithë se bashku për të bërë presion për zgjidhjen e tyre.

Me mirë duhet të njihet baza sindikaliste edhe me objektivat SPASH-it. E themi këtë edhe për faktin se në disa shkollë janë bërë përpjekje të tilla si "çfarë platforme kemi", "çfarë po bëni konkretisht për arsimin"?

Përgjigja e drejtuesve të SPA-se ka qenë e lexueshme dhe e qarte: "ne nuk jemi parti

politike, ne nuk jemi qeveria, ne nuk bëjmë ligje, ne kemi statutin e SPASH-it, kemi kontratën kolektive e cila nënshkruhet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, dhe nuk lejojmë që të shkelen të drejtat dhe lirite tona sindikaliste, të cilat janë përcaktuar në kontratë".


Njohja me problemet dhe shqetësimet që ka cob sindikate shkollë, na bën në si drejtues që këto probleme t'i përfshijmë në kontratën kolektive dhe të mos lejojmë shkeljen e të drejtave të cob mësuesi sindikalist.

Me gjithë këto probleme që rriten, vlen të përmendim se numri i anetareve të SPA-se në Qarkun e Tiranës sa vjen dhe po shtohet me anetare të rinjë. Kjo ka ardhur si rezultat i punës së drejtuesve sindikaliste nëpër shkollë, të cilët e kanë të qartë strategjinë e SPASH-it dhe janë të ndërgjegjshëm për këtë qëllim, gjë që forcon e fuqizojnë në shumë sindikaten.

Disa drejtues shkollash shprehin se në nuk mund të bëhemi anetare të SPA-se. Sipas Statutit, këta drejtues mund janë anetare të sindikates, por jo me të drejtë zgjedhjeje dhe vendimarrjeje, duke u siguruar atyre mbrojtje, sidomos për lirite sindikale dhe transferimet në punë.

Problemi vazhdon të rritet kutizimi sindikal, i cili nuk paguhet rregullisht. Kjo është një shkelje e njeres prej pikave që përmban Statuti. Të ardhurat nga kuotat e anetareve duhet të shkojnë në arken e sindikates, ato duhen të mbahen në bordero dhe të mos kalojnë dorë në dorë, sepse mund t'u hapim rrugë abuzimeve. Për këtë problem do të bashkëpunohet nga ne si drejtues kryesor të SPA-se Qarku Tirane, duke kontaktuar me komrat e rrethit.

Shaban DUKA  
Kryetar i SPA, Qarku Tirane.



SINDIKATA E PAVARUR  
E ARSIMIT TË SHQIPËRISË



FEDERATA E SINDIKATAVE  
TË ARSIMIT TË SHQIPËRISË



MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SHKENCËS

## KONTRATE KOLEKTIVE

Sot, më datën 4 korrik 2006, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në prani të palëve, nënshkruhet kjo Kontratë Kolektive Pune midis:

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësuar nga Ministri z. Genc Pollo, nga njëra anë dhe:

- Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), përfaqësuar nga Kryetari, z. Xhafer Dobrushhi

- Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), përfaqësuar nga Kryetari z. Bajram Kruja, nga ana tjetër.

Të dy palët, mbas negociemeve të

Neni 1  
Baza ligjore

Kjo Kontratë Kolektive nështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenet 50 dhe 51, në Konventat Ndërkombëtare të Punës, veçanërisht në Konventat nr. 87 dhe 98, në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 159-188 dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në tërësi dhe ato në fushën e arsimit në veçanti.

Kjo Kontratë Kolektive Pune, nështetet gjithashtu në dispozitat e Kontratës së mëparshme Kolektive të nënshkruar me 15 Maj 2002 dhe në bazë të nenit 114 të Kodit të Punës, ruan e miron amtitjet e saj të deritanishme në favor të punëmarësve, veçanërisht në fushën e shpërblyeve, të kushteve të punës, lirive sindikale etj.

Neni 2

Fusha e zbatimit të Kontratës

2.1. Kjo kontratë i shtrin efektet e saj mbi të gjithë personelin mësimor të sistemit parauniversitar, përfshin edukatorët e kushteve, mësuesit e ciklit

zhvilluara, arritën në përfundimin që të përsëritin Kontratën e deritanishme Kolektive të Punës, duke i bërë asaj plotësimet dhe përmirësimet e nevojshme dhe duke e shtrirë periudhën e Kontratës së re nga data e nënshkrimit të saj deri në 31 Dhjetor 2009.

Në procesin e negociimit me punëdhënësin, të dy sindikatat nënshkruese provuan edhe një here identitetin e tyre, përfshirë depozitimin e vendimeve në Gjykatën e Tiranës, që i njih ato si persona juridike, statutet përkatëse, numrin e anëtarësisë me lista dhe me kuotizacion, si dhe Marrëveshjen

të ulët dhe të lartë të shkollës 9-vjeçare, mësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme, profesionale e speciale.

2.2. Për arsimin parashkollor dhe parauniversitar, për punonjësit ndihmës që janë në vartësi të Drejtorive Arsimore Rajonale, kontratat kolektive të nivelit të dytë lidhen midis DPA dhe Seksioneve Sindikale të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

2.3. Dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha nivelet e tjera që legjitimohen për nënshkrimin e Kontratave Kolektive të nivelit të dytë, në kuptimin që këto subjekte nuk mund të përfshijnë në kontratë më pak të drejta për punëmarësit se sa Kontrata Kolektive e nivelit të parë.

2.4. Palët nënshkruese në kontratat kolektive të nivelit të dytë, nështetur në natyrën e kërkesave në nivel lokal, në veçoritë e kushteve të punës, mund të përfshijnë në kontratën kolektive të nivelit të dytë të drejta dhe përfitime në favor të punëmarësve në një vëllim në të madh se ato të nivelit të parë, me kusht që këto të drejta dhe përfitime të mos bien në kundërshtim me dispozitat

që kanë të dy sindikatat për t'u paraqitur si palë e vetme përpara punëdhënësit për negociimin dhe nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës. Në bazë të këtyre dokumenteve, SPASH dhe FSASH rikonfirmohen nga punëdhënësi, si partnerët e vetëm në rolin e punëmarësit për gjithë sistemin e të punësuarve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Te dy palët konfirmojnë se në përfundim të bisedimeve arritën të formulojnë dhe nënshkruajnë tekstin përfundimtar të Kontratës së re Kolektive të Punës, me përmbajtjen që vijon:

e shprehura në mënyrë ndaluese në legjislacionin e marrëdhënieve të punës ose dispozitat e Kontratës Kolektive të nivelit të parë.

25. Pala e sindikatës në momentin e lidhjes së kontratave të nivelit të dytë, duhet të paraqesë listën zyrtare të anëtarëve të sindikatës së saj.

Neni 3

Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo Kontratë Kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj dhe deri në 31 Dhjetor 2009. Mbas këtij afati, nështetur në nenin 173 pika 3 të Kodit të Punës, Kontrata Kolektive mund të zgjidhet me kërkesën e secilës palë, por me kusht që pala e interesuar të njoftojë tërheqjen 6 muaj më parë.

Neni 4

Punësimi

4.1. Të dy palët bien dëkord që kur ndodhin mosmarrëveshje ose konflikte që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, përfshirë masat disiplinore, transferimet, largimet nga puna, shpërblyerimet, pagat, lejet e zakonshme

dhe të jashtëzakonshme etj, SPASH dhe FSASH marrin në mbrojtje, duke u ballafaquar vetë si institucione me punëdhënësin e çdo niveli, vetëm ata mësues apo punonjës që janë anëtarë të tyre.

4.2. Anëtarë të sindikatës konsiderohen vetëm ata mësues apo punonjës, që janë deklaruar me shkrim për anëtarësimin në njerën nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate dhe që paguajnë rregullisht kutizacionin sindikal, sipas mënyrës dhe masës që përcaktohen në Statutet e secilës sindikate.

4.3. Kriteret për punësim që prandhen nga të dy palët nënshkruese me këtë Kontratë Kolektive, të cilat janë të nënshtritura në dispozitat përkatëse të Kodit të Punës dhe në Konventat Ndërkombëtare të Punës, duhet të jenë të harmonizuara me Aktet Normative që miratohet dhe nxjerr Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe nuk duhet të ketë mospajtim midis tyre.

4.4. Më kryesoret nga këto kritere janë:

a. Punonjësit që do të punësohen në sistemin arsimor parauniversitar duhet të kenë mbushur moshën 18 vjeç.

b. T'i përgjigjen nivelit arsimor për të gjitha ciklet, sipas kritereve që ka miratuar Ministri i Arsimit dhe Shkencës në Aktet Normative dhe konkretisht:

- Për arsimin parashkollor dhe për ciklin e ulët të shkollës 9-vjeçare, të paktën diplomën e shkollës së mesme pedagogjike, ose të një shkolle tjetër të profilizuar për mësuesit, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizikulturës.

- Për ciklin e lartë të arsimit bazë, diplomë të shkollave të larta të mësuesisë 4 ose 3 vjeçare, si edhe diplomë të ish-Institutive Pedagogjike dy vjeçare.

- Për t'u punësuar si mësues i përhershëm në shkollën e mesme, i punësuar duhet të disponojë diplomën universitare të shkollës së lartë.

- Personi që merret në punë për herë të parë pajiset nga punëdhënësi me Librezë Pune, e cila është unike për të gjithë të punësuarit, sipas modelit të përcaktuar nga organi kompetent.

4.5. Në vitin e parë të punësimit, që vjen menjëherë pas nbarimit të shkollës, i

punësuarit në arsim në të gjitha nivelet, që nga kopshtet deri në shkollën e lartë punësohet me kontratë individuale me afat të caktuar, (neni 149 i Kodit të Punës). Ky afat në të gjitha rastet është njëvjeçar.

Nëse me nbarimin e këtij afati nuk do të ekzistojnë kushte ligjore ose të parashikuara në këtë Kontratë Kolektive, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të punës dhe kur punëdhënësi u është përgjigjur me korrektesë detyrimeve që përmban për të kontrata individuale, atëherë i punësuarit fiton të drejtën e punësimit me kontratë pune pa afat të caktuar.

4.6. Gjatë periudhës njëvjeçare të punës, mësuesit, edukatorët ose mësimepunëdhënësit e tjerë gëzojnë po ato të drejta që gëzojnë edhe kolegët e tyre të punësuar në mënyrë definitive.

4.7. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa shkaqe të arsyeshme. Shkaqe të paarsyeshme konsiderohen ato që përmban neni 146, pika 1, shkronjat a, b, c, d, dhe e, i Kodit të Punës.

4.8. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Në këtë rast punëdhënësi detyrohet t'i paguajë dëmshpërblim punëdhënësit deri në një vit pagë dhe, me kërkesën e Sindikatave Qendrore nënshkruese të kësaj Kontrate ose me vendim gjykatë të formës së prerë, ta rikthejë punëdhënësin në punën e mëparshme. (Neni 146, pika 3 e KP).

4.9. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, siç është reforma në arsim, pakësimi i numrit të nxënësve, etj., punëdhënësi është i detyruar të zbatojë ndaj punëdhënësit këto afate njoftimi:

- Një muaj për të punësuarit që kanë një vit pune.

- Dy muaj për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet pune

- Tre muaj, për të punësuarit që kanë më shumë se 5 vjet pune.

4.11. Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëdhënësi bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 153 deri 156 të KP.

Punonjësit jo mësues, përfshirë të punësuarit në administrate, në konvikte, pastueset, rojet etj., kur merren në punë për herë të parë i nënshtrohen periudhës 3 mujore të provës, sipas nenit 142 të Kodit të Punës.

Kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësojnë punonjësit jo mësues në arsimin parauniversitar në periudhën e provës, miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës.

4.12. Punonjësit që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4.4, 4.5 dhe 4.7 të kësaj Kontrate Kolektive, mund të punësohen në arsim si përjashtim dhe vetëm në mënyrë të përkohshme.

4.13. Kur për një vend pune konkurrojnë dy ose më shumë kandidatura, punëdhënësi, drejtori i DAR ose drejtori i ZA, krijon një komision të posaçëm me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sindikatave, i cili bën përzgjedhjen mbi bazën e këtyre kritereve:

- Nivelin arsimor, notën mesatare, vjetërsinë në punë në arsim, duke preferuar ata mësues që kanë punuar për një periudhë në të gjatë se 3 vjet larg vendbanimit ose në zra të vështira.

- Kurset e kualifikimit dhe specializimit e njdhura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përfshirë titujt shkencorë ose pedagogjikë që ka mbrojtur dhe fituar kandidati që konkurron.

4.14. Kushtet e punësimit të personelit në institucionet e arsimit special dhe të institucioneve të tjera botuese ose të shërbimit do të trajtohen me kontrata të nivelit të dytë.

4.15. Në vendet që krijohen të lira për punësim, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 4.13, kanë përparësi edhe mësuesit e cilësuar "invalidë pune" me vendim të komisionit përkatës.

Neni 5

Ndërshimi i vendit të PUNËS

5.1. Sindikatat nënshtrimitin kërkesat e anëtarëve të tyre të punësuar në arsim

Vijn nga faqja 9

për ndryshimin e vendit të punës. Sindikatat, së bashku me kërkesën e të punësuarit, i paraqitin punëdhënësit përkatës edhe mendimin e tyre me shkrim dhe të argumentuar, jo më vonë se data 15 maj të çdo viti.

5.2. Miratimin ose mosmiratimin e kërkesës së punëmarrësit për ndryshimin e vendit të punës, punëdhënësi është i detyruar t'ia njoftojë me shkrim punëmarrësit 30 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

5.3. Ndryshimet e vendit të punës të bëra për shkakë dojqitive me iniciativën e punëdhënësit, bëhen vetëm për raste të veçanta dhe për nevoja mëdhorë në arsim. Si rregull, punëmarrësit i ndryshohet vendi i punës vetëm para fillimit të vitit mësimor dhe duhet t'u pëmbahet këtyre kriterëve:

- Kualifikimit,
- Vjetërsisë në punë,
- Rezultateve në punë,
- Nivelit arsimor,
- Gjendjes shëndetësore, në kuptimin që lëvizja në punë nuk duhet të ndikojë në keqësimin e shëndetit të punëmarrësit.
- Kushteve ekonomike dhe të jetesës, në kuptimin që lëvizja në punë nuk duhet të sjellë për punëmarrësin uljen ose përkeqësimin e këtyre kushteve.
- Disiplinës në punë dhe zotimit të ligjt.

- Për gratë me fëmijë nën moshën tre vjeç, lëvizja në punë nuk bëhet kur rrua vajtje-archje zgjat në shumë se 30 minuta në këmbë, me përjashtim të rasteve kur transferimi bëhet me kërkesën e punëmarrësit ose është në favor të tij.

5.4. Në çdo rast ndryshimi i vendit të punës bëhet vetëm brenda njësisë administrative në juridiksion të Zyrës Arsimore dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale.

5.5. Urdhri për ndryshimin e vendit të punës duhet t'i jepet punëmarrësit me shkrim dhe i motivuar, 30 ditë para ekzekutimit të parashkuar.

5.6. Punëdhënësi është i detyruar të

ruajë vendin e punës:

- për gratë shtatzana ose me leje për mirënjohjen e fëmijëve,
- për punonjësit që nuk gëzojnë shëndet të plotë dhe që këtë e provojnë me raport mjekësor, për aqkthë sa zgjat pëaftësia e përkohshme. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe punëmarrësit që marrin leje për kujdes familjar, me ose pa të drejtë rroge sipas akteve ligjore dhe rënligjore në fuqi.

5.7. Me kërkesën e sindikatave nënshkruese, punëdhënësi është i detyruar t'i verë në dijeni atpër motivet e transferimit, për pasojat juridike, ekonomike dhe sociale që vijnë në këtë rast.

Kur ka kundërshtime nga sindikata ose i interesuari, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, palët duhet të bëjnë konsultime dhe të gjejnë zgjidhjet ligjore, në të kundërt secila palë rezonon të drejtën t'i drejtohet Zyrës së Rajnimit, në rast të kundërt i drejtohen Gjykatës, vendimet e të cilës janë të detyrueshme për palët.

5.8. Punëdhënësi mund t'i ndryshojë vendin e punës punëmarrësit gjatë procesit mësimor vetëm në raste përjashtimore:

- Kur kemi të bëjmë me thyerje të rënda të disiplinës në punë, me shkelje të ligjit ose të kontratës kolektive.
- Për nevoja mëdhorë në arsim. Në këto raste duhet të merret meberos pëlqimi i FSASH ose SPASH, kur dojqit i lëvizjes në punë janë anëtarët e tyre dhe lëvizja nuk mund të zgjatë më shumë se 1 vit.
- Kur nuk plotësohet norma e ngarkesës mësimore për punëmarrësin.

#### Neni 6 Koha e PUNËS

6.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate, brenda vitit 2007 të studiojë ngarkesën mësimore të mësuesve të arsimit parauniversitar, duke përfshirë në elementin "ngarkesë" edhe komponentë të tjerë, të cilët mësuesi i përballon aktualisht, por që nuk i njihen në ngarkesë.

6.2. Kohëzgjatja e punës javore është 5 ditë në javë, nga e hëna deri të prenten.

6.3. Ngarkesa aktuale mësimore javore për punonjësit mësimorë (edukato-rët) në arsimin parashkollor është 30-36 orë në javë.

6.4. Ngarkesa mësimore javore për punonjësit në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm të jetë konform Udhëzimeve të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Mësuesit të ciklit të ulët dhe mësuesit që ka klasë në kujdestari, i karasvlerësohet kjo punë me një orë suplementare.

6.5. Ngarkesa mësimore e punonjësave mësimorë në arsimin parauniversitar do të jetë në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

6.6. Ngarkesa aktuale mësimore e mësuesve të cilësuar "invalidë pune" do të jetë në përputhje me Vendimin e KMCAP.

6.7. Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë suplementare të pagueshme deri në 30% të ngarkesës mësimore.

6.8. Mësuesit e cilësuar "invalidë pune" nuk mund të ngarkohen mbi normë.

6.9. Në rastet kur nuk plotësohet norma mësimore pagesa të bëhet konform udhëzimeve për ngarkesën mësimore.

6.10. Orët shtesë mbi normë për veprimtaritë mësimore-edukative në ditët e pushimit javor për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare që bëjnë DAR dhe ZA, do të pagohen sipas neneve 91, pika 3 e KP.

6.11. Mësuesi është i detyruar të paraqitet në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimit të tij. Mas kryerjes së orëve ditore të mësimit, nëse nuk ka angazhime të tjera që lidhen me detyrën e tij si mësues dhe detyrat që i ngarkohen nga drejtoria e shkollës, ai mund të largohet nga shkolla.

6.12. Në raste të veçanta, me miratimin e Drejtorisë Arsimore, mund të angazhohen edhe mësues që janë në pritmëri për t'u emëruar ose mësues pensionistë, deri në 10 orë mësimi në javë, plus orët e provimeve sipas akteve rënligjore.

6.13. Koha e punës për të punësuarit e tjerë të përcaktuar në Nenin 2 të kësaj

Kontrate rregullohet me VKM.

6.14. Ministria e Arsimit dhe Shkencës angazhohet të marrë masat e nevojshme për normalizimin e numrit të nxënësve në klasë, në ato zona ku ky fenomen është problem.

6.15. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të marrë masat e nevojshme për studimin e numrit të nxënësve për klasë, në sistemin arsimor parauniversitar, me synimin që të arrijë gradualisht në 32 nxënës për klasë.

#### Neni 7

##### Koha e pushimit

7.1. Edukatorët e arsimit parashkollor gëzojnë të drejtën e lejes vjetore të pagueshme prej 32 ditë pune në vit pa ndërprerje.

7.2. Mësuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të gjitha kategorive si dhe pedagogët e shkollave të larta gëzojnë të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 56 ditë pune, e cila përfshin, përveç pushimeve verore, edhe ditët e pushimit kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor. Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë dhe kjo vetëm për punë arsimore dhe edukative.

7.3. Të punësuarit në institucionet që varen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, administrata e sistemit arsimor, si edhe punonjësit e shërbimeve gëzojnë të drejtën e pushimeve vjetore sipas kriterëve të caktuar me VKM, por jo më pak se 4 javë kalendarike.

7.4. Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paftësisë së përkohshme në punë.

7.5. Punëtarësit anëtarë të sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate, në rast martesë ose vdekjeje të bashkëshortit, të paraardhësve ose pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, të motrave dhe vëllezërve, përfitojnë një pushim të paguar prej 5 ditësh.

7.6. Në rast sëmundjeje të rëndë të paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punonjësit e arsimit, anëtarë të sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate, përfitojnë deri në 10 ditë leje të papagueshme në muaj, por jo më

shumë se 6 muaj rresht.

7.7. Me kërkesën e SPASH dhe FSASH, të zgjedhurve në kryesitë e sindikatave në shkallë rrethi dhe këshilli sindikal, u sigurohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kërkesa i paraqitet DAR ose ZA nga kryesitë e seksioneve sindikale vendore, të paktën 5 ditë para aktivitetit.

#### Neni 8

##### Sistemi i pagave dhe SHPËRBLIMEVE

8.1. Mëshetur në Strategjinë e Arsimit parauniversitar dhe në Programin e Qeverisë, që e konsideron arsimin si sektor parësor, të dy palët bien dakord që të ndërtojnë e zbatojnë një sistem pagash dhe shpërblimesh që mundëson një vlerësim në të mirë të figurës dhe punës së mësuesit e pedagogut dhe një motivim në të madh të tij, në bazë të angazhimit në procesin e reformimit e modernizimit të arsimit dhe të cilësisë së punës që kryen.

8.2. Punëdhënësi dhe punëtarësi bien dakord që, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane, të garantojnë për të punësuarit pagë të barabartë për punë të barabartë dhe profesion të njejtë, pa asnjë dallim.

8.3. Pagat e punonjësve mësimorë dhe ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar janë sipas strukturës së pagave të miratuara me VKM nr. 194 datë 22.04.1999 dhe të plotësimeve, shtesave e ndryshimeve të bëra në këtë vendim, ose me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, që liden me rritjet dhe përmirësimet e herëpashershme të pagave të punonjësve të arsimit.

8.4. Në bazë të nenit 1 të Ligjit nr. 8487 datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", për ndryshimet, shtesat, plotësimet, përmirësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të arsimit parauniversitar, që mirëkohen me këtë Kontratë Kolektive, punëdhënësi

është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e sindikatave nënshkuese të kësaj Kontrate Kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dërgohen në Qeveri.

8.5. Në bazë të nenit 21 të Kartës Sociale Evropiane për të drejtën e partnerëve socialë për informim dhe me qëllim që të luftohen me efikasitet shpërdorimet dhe korrupsioni në menaxhimin e buxhetit të arsimit, sidomos për pagat, shpërblimet, shpenzimet operative dhe investimet, punëdhënësi është i detyruar që të njohë përfaqësuesit kryesorë të Sindikatave Qendrore me të gjitha të dhënat përkatëse financiare, të burimeve njerëzore, etj.

8.6. Paga e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni të kësaj Kontrate Kolektive është e garantuar për të gjithë të punësuarit në arsim në mënyrë definitive.

8.7. Me kërkesën e sindikatave nënshkuese të Kontratës Kolektive, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bie dakord t'i propozojë Qeverisë, që në Vendimin e KM nr. 194 datë 22.04.1999, të bëhen këto shtesa:

a. Në lidhjen nr. 1 "Struktura e pagës për vjetërsi mësimore", që i bashkëngjitet këtij vendimi, në kolonën "shtesa për vjetërsi në punë", shtesa prej 2% në vit të jetë për vjetërsi në punë dhe jo vjetërsi në profesion, duke shfrytëzuar pikën (2) II, të vendimit nr. 194.

b. Në kolonën "shtesa për kualifikim" të po kësaj Lidhjeje të shtohet një element i katërt për ata mësues që kanë rriti 25 vjet pune, të cilët shtesën për kualifikim duhet ta përfitojnë jo 20% siç është sot, por 25%.

8.8. Shpërblimet dhe përfitimet që liden me pikën 8 të këtij neni janë:

a. Kur jemi përpara kërkesave që liden me nevoja madhore në arsim, siç është rasti kur në zona të thella apo të largëta rurale, ose si përjashtim edhe në zona urbane, ka mungesa mësuesish me arsim përkatës, drejtorët e DAR ose ZA, mbasi marrin mendimin me shkrim

Vijon nga faqja 11

të partnerëve sindikalë vendorë, mund të enërojnë dhe dërgojnë në këto vende pune mësues me kualifikimin përkatës, vetëm me kontratë njëvjeçare, e cila mund të përsëritet, duke i paguar sipas vendimeve në fuqi.

b. Në fund të çdo viti mësimor, DAR dhe ZA, në bashkëpunim me seksionet sindikale përkatëse, duke u mbështetur në auditimet e kryera dhe në vlerësimet që bëjnë drejtorët e shkollave dhe këshillat sindikale përkatëse, shpallin për çdo shkollë e mreth mësuesit në të mirë të vitit.

8.9. Kur mësuesit kryejnë ore mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të parashikuar në këtë kontratë, orët suplementare u paguhen sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

8.10. Mësimdhënësit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin një shtesë në pagë sipas kriterëve që pëmban V.K.M nr. 230, datë 19.04.2006. Masa e shpërblyimit për mësuesit që punojnë brenda njësisë administrative të DA të tyre dhe që kthehen brenda ditës në shtëpi bëhet sipas vendimeve përkatëse për pagesa.

8.11. Mbështetur në nenin 117 të Kodit të Punës, nga paga mujore e mësuesit bëhen vetëm këto zbritje:

- a- Tatimi mbi të ardhurat e punonjësit.
- b- Kontributet e sigurimeve shoqërore të caktuara me VKM.
- c- Kutizacioni i anëtarësisë në sindikatë mbi bazë vullnetare.

8.12. Sindikatat, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, marrin përsipër të negociojnë me Këshillin e Ministrave, për masën e shpërblyimit, nga fondi i veçantë, të punonjësve mësimorë të sistemit të arsimit parauniversitar, në raste eventesh, fatkeqësish, martesë, vdekje në familje etj.

8.13. Me autorizim me shkrim nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, mësuesit që dalin në pension përfitojnë deri në dy paga mujore shpërblyim, brenda buxhetit vjetor të planifikuar për çdo njësi administrati-ve, si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## Neni 9

### MBËSHTETJA E

#### STRATEGJISË, REFORMIMIT DHE MODERNIZIMIT TË ARSIMIT

9.1. Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, konfirmojnë se arsimit cilësor publik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës do të jenë prioritet i punës së tyre, se mbështesin dhe përfshihen aktivisht në procesin e zbatimit të Strategjisë së Arsimit, për reformimin dhe modernizimin e këtij sektori dhe se vlerësojnë programin e Qeverisë që e ka shpallur arsimin sektor prioritar.

9.2. Njëpërmjet seminareve, tryezave, diskutimeve në këshillat sindikale e forumet sindikale, sindikatat do të zërthejnë aspekte të veçanta të Strategjisë së Arsimit, përfshirë kurrikulat, procesin e vlerësimit, të motivimit, tekstet etj, duke e vënë theksin në njohjen dhe zbatimin e këtyre kërkesave nga mësuesit dhe antarët sindikal.

9.3. Të dy sindikatat bien dakord që të bashkërendojnë punët për arritjen e këtyre qëllimeve.

## Neni 10

#### ANGAZHIM PËR ULJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE QË BRAKTISIN SHKOLLËN DHE ELEMENIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE.

10.1. Të dy sindikatat e arsimit, FSASH E SPASH, angazhohen që me mundësitë e tyre dhe me mbështetje të tjera, sidomos nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, nga sindikatat homologe, etj, të bëjnë një punë të veçantë për uljen e numrit të fëmijëve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

10.2. Njëpërmjet trajnimeve të drejtuesve sindikal dhe të anëtarëve të sindikatave si dhe njëpërmjet formave të tjera të punës konkrete në shkollë e në komunitet, ato do të synojnë për mitjen e mësuesve të angazhuar në një punë të veçantë me nxënësit që braktisin shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, duke krijuar për ta një mjedis në tërësi dhe në prindëror dhe

duke pasur si dobjektiv eliminimin e punës së fëmijëve.

10.3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, duke e patur si një mër prioritetet e strategjisë së saj, mbështet këtë angazhim dhe siguron gadishmërinë e administratave të shkollave për veprime të përbashkëta, duke nxitur edhe përfshirjen e organeve të nxënësve dhe prindërve që veprojnë në shkollë.

## Neni 11

### Kushtet e punës

11.1. Shteti subvencionon shpenzimet për transportin e mësuesve dhe nxënësve të arsimit të detyruar që punojnë e mësojnë larg vendbanimit të tyre dhe që kthehen brenda ditës në vendbanim sipas vendimeve përkatëse.

11.2. Në kuadrin e marrëveshjeve midis dy palëve, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, në konsultim me sindikatat, kriteret për kualifikimin e mësuesve.

11.3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me sindikatat, të përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen, emërimin dhe kualifikimin e drejtuesve të shkollave.

11.4. Bazuar në Udhëzimin nr. 2 datë 25.06.2004 të Ministrisë së Punës, Qështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Shëndetësisë, të punësuarit në arsim si edukatore kopshti ose mësues në sistemin parauniversitar përfitojnë një herë në vit një ekzaminim mjekësor falas.

## Neni 12

MarRëdhëniet me pushtetin vendor, komunat, bashkitë, qarqet dhe prefekturat

12.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr përsipër që DAR dhe ZA të paraqiten si palë e përbashkët me Seksionet Sindikale në mrethe përpara komunave, bashkive, këshillave të qarqeve dhe prefektëve, për :

- a -sigurimin e kushteve normale të punës në shkollë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjediseve të saj;
- b - sigurimin e transparencës për mjetet financiare që caktojnë Këshillat e

Qarqeve, të Komunave dhe Bashkive për arsimin dhe mirëadministrimin e tyre; c - zbutjen dhe eliminimin e fenomenit të punës së fëmijëve;

d- të ndihmuar seksionet sindikale për vjeljen e kuotizacioneve të anëtarë-sisë, duke i zbritur ata nga paga në listë pagesa, mbështetur në nenin 117/2 dhe 181 pikë 7, shkronja "c" e Kodit të Punës.

Këto veprime, sektorët ekonomike të komunave dhe bashkive i kryejnë një herë në 6 muaj, ose kur është e mundur me shpesh dhe vetëm mbasi sindikatat paraqesin pranë qendrave ekonomike ose zyra të llogarisë së tyre, listat e anëtarëve, në të cilat mësuesi ose punonjësi i anëtarësuar deklaron se është anëtar i sindikatës pëkatëse për një periudhë prej jo më pak se një vit dhe se autorizon pagesën e kuotizacionit nëpërmjet listë-pagesave.

12.2. Masa e kuotizacionit për çdo anëtar përcaktohet në statutet, që secila sindikatë ka depozituar pranë punëdhënësit, ose në vendime të posaçme të këshillave të tyre drejtuese, duke respektuar marrëveshjet që sindikatat kanë ndërmjet tyre.

#### Neni 13 Liritë sindikale

13.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive në procesin e hartimit të Akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblyerjet, kushtet e punës, etj.

13.2. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate të pajisen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me aktet e nxjerra prej saj, jo më vonë se 20 ditë nga momenti i shpalljes së tyre.

13.3. Për të garantuar të zgjedhurit në vendet drejtuese sindikale në kryerjen e detyrës së tyre, përfshirë kryetarin, n/ kryetarin dhe sekretarin e Këshillit Sindikal të rrethit, si dhe kryetarët e Këshillave Sindikale në shkollë, punëdhënësit i ndalohet t'i largojë ata nga puna, ose t'u ndryshojë vendin e punës, pa marrë në parë pëlqimin me

shkrim të Kryesisë së SPASH e FSASH, përveç rasteve kur vërehen shkelje të ligjit ose të Kontratës kolektive ose individuale të punës.

13.4. Drejtuesve të Seksioneve sindikale në rrethe të secilës sindikatë nënshkruese të Kontratës Kolektive, për t'u mundësuar marrjen me veprimtari sindikale, mbështetur në nenin 181, pikë 7 e Kodit të Punës, u reduktohet ngarkesa mësimore javore, nga 5 deri në 10 orë në javë, si rregull, sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion.

Për Seksionet Sindikale në Qarqe, që kanë me shumë se 600 anëtarë, i reduktohet norma mësimore javore edhe një personi të dytë me 6-8 orë në javë.

Masa konkrete e reduktimit të ngarkesës mësimore javore për çdo drejtues seksioni vendoset me marrëveshje midis dy sindikatave dhe u njoftohet Drejtorive Arsimore Rajonale në fillim të çdo viti mësimor. Titullarët e Sindikatave Qendrore mund të anulohet në çdo kohë kërkesën e tyre për ulje të normës mësimore për ata drejtues sindikalë vendorë që nuk e justifikojnë këtë lehtësi që u bëhet.

13.5. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive njihen me të gjithë treguesit ekonomik-financiar në nivel qendror dhe lokal.

13.6. Me kërkesën e kryesive të dy sindikatave nënshkruese të Kontratës, Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë i venë në dispozicion të tyre, për t'u marrë me veprimtari sindikale, nga një mësues secila për secilën sindikatë me ngarkesa mësimore javore të reduktuar, duke i ngarkuar këta mësues me jo më shumë se 12 orë mësimi në javë.

13.7. Në pajtim me nenin 181, pikë 6 e Kodit të Punës, të zgjedhurit në organet sindikale në qendër e në rrethe, me ndarimin e mandatit, kanë të drejtë për t'u rikthyer në punë në profilin e tyre.

13.8. Dita e Mësuesit, 7 Marsi dhe Dita Ndërkombëtare e Mësuesve, "5 Tetori" do të jenë në të gjithë vendin ditë veprimtarish kushtuar kësaj feste.

13.9. Veprimtaritë sindikale zhvillohen në mjediset e shkollës, pa dëmtuar procesin mësimor. Seksionet dhe

Këshillat Sindikale kanë të drejtë të shpërndajnë dhe publikojnë në mjediset e shkollës, njoftime, programe, dojektiva, përfshirë Kontratën Kolektive dhe dokumente të tjera të tyre.

13.10. Kryetarëve të Këshillave Sindikale në shkollë që përfaqësojnë në shumë se 15 anëtarë, nuk duhet t'u japet klasë në kujdestari.

13.11. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas mundësive të saj, u siguron dy sindikatave qendrore, mjedise dhe paisje për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre, ndërsa Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të rretheve brenda mundësive të tyre t'u sigurojnë anijente dhe paisje pune seksioneve sindikale të FSASH dhe SPASH.

13.12. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të seksioneve sindikale të rretheve në mbledhjet e këshillave drejtuese qendrore të tyre, për 4 (katër) mbledhje në vit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore të rretheve, mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, mbi bazën e vërtetimeve me shkrim të lëshuara nga kryesitë e sindikatave qendrore.

#### Neni 14 Statusi i MËSUESIT

14.1. Te dy palët bien dakord që të intensifikojnë punën e nisur për përfundimin brenda vitit të një drafti për Statusin e Mësuesit.

#### Neni 15 Zgjidhja e MOSMARRËVE SHJEVE

15.1. Për rastet kur ka shkelje, keqinterpretim apo keqzbatim të një ose disa neneve të kësaj Kontrate, pala e interesuar do të ndjekë procedurën e nëposhtme për zgjidhjen e tyre:

a-Të punësuarit sipas kësaj Kontrate, kur kanë ankesa, së pari duhet ta diskutojnë dhe ta zgjidhin çështjen me titullarin e institucionit me mirëkuptim dhe, kur ai e shikon të nevojshme, i shoqëruar nga Kryetari i sindikatës ku ai bën pjesë.

Vijn nga faqja 13

b-Nëse ankesa nuk zgjidhet me mirëkuptim sipas pikës 14.1 i interesuari ose sindikata i drejtchet me shkrim titullarit të institucionit, në të cilin ka lindur ankesa, brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës, duke parashtruar edhe arsyet e saj.

c-Në parashtrimin e ankesës duhet të përfshihen: emri i të punësuarit, paraqitja e fakteve, përcaktimi i nenit të shkelur në kontratë me referencat përkatëse, si edhe shkeljet e akteve ligjore ose rregullore.

d-Brenda 10 ditëve, pasi marr ankesën, titullari i institucionit komunikon vendimin me shkrim për ankuesin.

e-Brenda 30 ditëve pasi marr vendimin e titullarit, ankuesi mund ta apelojë këtë vendim tek instancat në të larta. Ai bëhet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me kopjen e vendimit të titullarit të institucionit.

f Titullari i instancës në të lartë ose një person i autorizuar prej tij, brenda 30 ditëve komunikon përgjigjen me shkrim për të interesuarin dhe për sindikatën.

g- Kur ankesa është në nivel sindikate rrethi, procedura e mësipërme ndiqet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, së bashku me përfaqësues të Kryesisë së FSASH dhe SPASH.

h- Nëse pas kësaj procedure, konflikti nuk gjen zgjidhje, pala e interesuar i drejtchet Gjykatës.

Neni 16

Detyrimet dhe sanksionet

16.1. Palët kontraktuese janë të detyruara të pëmbushin dhe respektojnë detyrimet që lindin nga Kontrata, duke respektuar kërkesat dhe duke zbatuar zgjidhjet që pëmbajnë nenet 169 deri 172 të Kodit të Punës.

Për S.P.A.SH.

K R Y E T A R I

*Bajram Kruja*

16.2. Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëntimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore:

- a Këshillim,
- b Vërejtje,
- c Vërejtje me paralajmërim,
- d Zbritje në detyrë deri në 6 muaj,
- e Dëshpërdolim i dëmit, në masën që vendos Gjykata, dhe
- f Largim nga puna

16.3. Në rast të thyerjes së rëndë të etikës në punë dhe të sjelljeve ekstremiste të padenja, nga ana e punëmarrësit mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në Nenin 153 të Kodit të Punës.

Neni 17

E drejta e aksionit sindikal dhe e GREVËS

17.1. Për arritjen e qëllimeve të tyre që janë mbrojtja e interesave dhe kërkesave sociale ekonomike të anëtarëve që përfaqësojnë, në mbrojtje të zhvillimit të reformës dhe modernizimit të arsimit, të mitjes së cilësisë së procesit mësimor, sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive, si partnere të ligjshme të punëdhënësit, MASH dhe Qeverisë, do të përdorin në radhë të parë negociimin dhe dialogun social, do të bëjnë argumentimin social e ligjor të kërkesave të tyre.

17.2. Por, nëse rrugët dhe mjetet sindikale që përshkruhen në pikën 1 të këtij neni nuk do të japin rezultat, në kuptimin që nuk do të çojnë në zgjidhjen e kërkesave të parashtruara, në bazë të nenit 50, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë, që garanton të drejtën e grevës dhe në bazë neneve 197, 197/1, 197/2, 197/3, 197/4, 197/8, 197/9 dhe 197/10, të Kodit të Punës, të dy

Për F.S.A.SH.

K R Y E T A R I

*Xhafer Dobrush*

Sindikatat Qendrore nënshkruese të Kontratës Kolektive kanë të drejtë të përshkallëzojnë lëvizjen sindikale me anë të protestave, manifestimeve deri te greva e pjesshme ose e përgjithshme.

Neni 18

Të ndryshme

18.1. Palët mund t'i bëjnë plotësimet dhe ndryshime kësaj Kontrate gjatë periudhës që ajo është në fuqi, në përputhje me ndryshimet që mund të rrobhin në legjislacion ose ndryshime të tjera, me pëlqimin e të dy palëve. Ndryshimet apo plotësimet do të bëhen vetëm me shkrim.

18.2. Palët mund të zgjidhin Kontratën në çdo kohë për shkak të arsyeshme të parashkuara në ligj. Për këtë është i nevojshëm njoftimi paraprak, me shkrim, zyrtarisht 3 muaj përpara. Po kështu, palët mund të vendosin zgjatjen e afatit të kësaj Kontrate tej asaj që është parashkuar në Nenin 3, por zgjatja duhet bërë me shkrim.

18.3. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të detyrueshme për të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit e nivelit të dytë, përfshirë Drejtoritë Arsimore e drejtoritë e shkollave, Prefekturat, Këshillat e Qarqeve, Bashkitë dhe Komunat si dhe Seksionet Sindikale të FSASH e SPASH.

18.4. Kontratat Kolektive të nivelit të dytë konsiderohen anekse të kësaj Kontrate dhe përfshijnë problematikën specifike vendore.

Kontrata Kolektive e Punës, hartohet në katër kopje të barazvlefshme, nga të cilat një depozitohet në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, një në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe nga një në secilën sindikatë nënshkruese.

Për MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

MINISTRI

*Geno Pollo*

## Të reja shkencore

### NJË MOUS ME TRE KARAKTERISTIKA TË REJA

Logitech është një novator i shkathët dhe mousi i fundit i kompanisë provon që Logitech nuk ndalon kurrë së pari përpara.



Para dy vjetësh Logitech futi teknologjinë e lazerit, si një standard për mousin pa kordon dhe konkurentët e ndoqën me shpejtësi. Versioni i ri, Revolucioni MX, ka tre karakteristika mbreslënëse që pa dyshim do të merren edhe nga kompanitë e tjera në vitet në vazhdim.

Mekanizmi qëndror që rrotullohet mund të vërtitet në qindra faqe Exeli ose dokumente në Word duke shtuar shpejtësinë ose duke e pakësuar atë deri sa të shkoni aty ku dëshironi.

Mousi ka edhe një buton që bën kërkime vetëm duke e shtypur një herë. Selektioni një fjalë ose një fjali, shtypni butonin me lente dhe një faqe e "Google search" shfaqet papritur. Në fakt mund të zgjidhni faqen ku doni të bëni kërkimet.

E reja e tretë është një mekanizëm që përdoret me gishtin e madh në anë dhe që shërben si përzgjedhës dritarësh. Në

Windows XP, ju duhet të shtypni ALT-TAB në të gjitha dritaret e hapura por mund të shihni vetëm emrin e një dritareje. Nëse keni 30 dritare të hapura, mund të duhet pak kohë për të gjetur atë që kërkon. Mousi i Logitech i liston të gjitha dritaret e hapura me emrat e tyre dhe dridhet kur shfaqet lista. Revolucioni MX ka një bateri të karikueshme që ndodhet në pjesën e poshtme dhe një tregues baterie në anë.

Për momentin cmimi është 100 USD, por ia vlen për ta bërë tuajin.

### LAVATRICJA QË LAN RROBAT PA UJË

Lavatricja e re e Sanyos, Aqua AWD-AQ1, mund të lajë rrobat tuaja pa ujë. Oksigjeni në ajër konvertohet në ozonë, duke përdorur një pajisje që krijon ozonin, dhe sprucohet



në rrobat brenda lavatricses. Ozoni ka një veprim të fuqishëm oksidimi, që ose shkatërron ose shpërbën muret që krijojnë bakteret. Kjo lejon që të eliminohen bakteret, erërat dhe papastërtia. Deklarata për shtyp e Sanyos thotë: "Kohët e fundit produktet që eliminojnë bakteret dhe erërat janë shumë popullore dhe Aqua AWD-AQ1 bën pothuajse të njëjtën gjë vetëm se ndodh brenda lavatricses". Kjo makineri ka, gjithashtu, një cikël larjeje normal që përdor

ujin e ricikluar nga cikli i shpëlarjes dhe ozoni së bashku, gjë që con në një rënie të thëksuar të përdorimit të ujit në krahasim me lavatricet tradicionale. Ujë që është përdorur për të shpëlarë ruhet në një vaskë, ku injektohet ozon për të pastruar ujin. Ky ujë përdoret përsëri ose për larjen tjetër ose në formë avulli për të tharë rrobat.

### MBËSHTILL DHE LUAJ NË PIANO

Muzikantë në lëvizje, gëzohuni. Pianoja Portative që mbështillet, rrotullohet si një batanije dhe hapet deri në 91cm në gjatësi. Ajo ka të inkuorporuar teknologji që përdoret në butonat e telekomandave dhe



pjesë që përdoren me prekje, një tastjerë prej gome e silikoni me një box të integruar në të dhe mund të luajë deri në 15 orë me katër bateri AA. Por kjo nuk është dhe aq e lehtë. Ajo përbëhet nga 128 tone, 100 ritme, 20 këngë demo të regjistruara më parë dhe një box që lidhet me kompjuterin.

Shpikësi i saj është Ymano Music dhe vlera arrin në 160 USD.

## Keshilla praktike

# SHTATË GJËRA QË I DUHEN THENE NJË PUNËDHËNËSI GJATË NJË INTERVISTE PUNE

Intervista nuk është një pyetësor, por një bashkëbisedim. Pra për ta bërë të tillë, duhet të keni gati një sërë historish të vogla për punën dhe jetën tuaj personale

Kur shkoni në një intervistë, duhet t'i lini nervat mbrapa derës. Mënyra më e mirë për t'u përgatitur është të jeni vetvetja dhe mënyra më e mirë për të qenë vetvetja është të tregoni historitë tuaja.

Në intervistat tradicionale, punëdhënësi do t'ju bëjë pyetje që do të fokusohen në aftësitë tuaja në punë dhe në njohuritë që nevojiten për të kryer punën. Një aspekt i rëndësishëm i intervistave të kohëve të fundit janë edhe pyetjet lidhur me karakterin tuaj dhe sjelljet personale që mund të përcaktojnë më mirë nëse ju jeni i përshtatshëm për kompaninë. Intervistuesi kërkon të dijë si keni reaguar për situata të

ndryshme në të kaluarën.

Punëdhënësi do që të zbulojë:

- Jeni aktiv dhe i besueshëm? Me fjalë të tjera, a do të bëni para për kompaninë dhe do dini t'i menaxhoni ato?

- A punoni mirë në grup? A do të përshtateni në hierarkinë e kompanisë?

- A do të përshtateni me kulturën e kompanisë? Ata nuk duan prima donna.

Mënyra më e mirë për të treguar këto tipare tuajat është të merrni iniciativën dhe të përgatisni histori personale të ndryshme që mund t'i tregoni, por të mos zgjasin më shumë se 30 deri në 90 sekonda secila.

Filloni të zhvilloni historitë tuaja rreth këtyre shtatë fushave:

1. Një rast kur ju bëtë që kompania juaj të fitonte para dhe mënyrën si i kursyet ato.

2. Një krizë në jetën ose në punën tuaj, si reaguat dhe si e kaluat.

3. Një rast kur ju ishit pjesë e një grupi pune dhe cili ishte kontributi juaj.

4. Një rast në karrierën tuaj kur ju desh të kapërcenit stresin

5. Një rast në punën tuaj kur ju drejtuat suksesshëm një projekt.

6. Një dështim që ju ndodhi në punë dhe si e kapërcyët atë.

7. Çdo ngjarje kryesore që ka ndodhur gjatë karrierës suaj që ju ka bërë të ndryshoni drejtimin dhe cili ishte rezultati për ju.

Mbani mirë parasysh se është bashkëbisedimi ai që bën që të fitohet një intervistë, pra është bashkëbisedimi ai që bën që të fitohet një punë. Prandaj, për të patur një bashkëbisedim të frytshëm, bëni gati historitë tuaja.

Përgatiti faqen Eriona Vargjeli

# Tribuna sindikale

